



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.32/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësit Gjakova Sh.A., me seli në Gjakovë, rr. “UCK” nr.7, kundër debitorit Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, me çështjen përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, më datën 04.06.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e debitorit Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, e ka hedhur poshtë si të pa lejueshëm prapësimin të ushtruar nga debitori Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.512/2022, të datës 13.09.2022 i lëshuar nga përmbartuesi privat Gjokë Radi nga Gjakova.

Ankesë ka paraqitur debitorit Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të parashkrimit të kërkesës se kreditorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

*Ankesa e debitorit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetës Gjako Sh.A., me seli në Gjakovë, me datën 18.03.2019 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, në bazë të dokumentit të besueshme faturës- Ekstraktit nga librat e kontabilitetit për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 01.09.2022, për shumën e detyrimit në vlerën prej 212,47€, me kamatë ligjore prej 8% si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat Gjakë Radi, me seli në Gjakovë, me Urdhrin Përbarimor P. nr.512/2022 të dt.13.09.2022, ka caktuar përbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm- Ekstraktit nga librat e kontabilitetit për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 01.09.2022, i plotëson kushtet për përbarim.

Ndaj këtij urdhri për lejimin e përbarimit të përbaruesit privat, ka ushtruar prapësim debitorit, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoje prapësimin si të bazuar dhe ta anulojë urdhrin për përbarim.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të hudhet si i palejuar.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2351/22 të datës 18.08.2023, e ka hedhur poshtë si të pa lejueshëm prapësimin të ushtruar nga debitori Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, me seli në Gjakovë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.512/2022, të datës 13.09.2022 i lëshuar nga përbaruesi privat Gjakë Radi nga Gjakova.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se gjykata e shkallës së parë pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe se prapësimi i ushtruar nga debitori në rastin konkret kundër urdhrin për përbarim është i pasafatshëm, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me ushtrimin e prapësimi me vonës rreth 14 ditë, pasi që me datën 16.09.2022 debitorit ka pranuar urdhrin përbarimor, ndërsa ka paraqitur prapësim ndaj këto urdhrin në datën 07.10.2022, fakt ky që vërtetohet me vulën postare me nr. rekomand R.2588180. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përbarimor

përkatësisht dispozitën e nenit 70 ku përcaktohet se “ *Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues*”. Ndërsa më dispozitën e nenit 126 par.2 të LPP-së theksohet se “ *Në qoftë se kreditori nuk e cakton në mënyrë decidive llojin e kalimit të kredisë, konsiderohet se e propozon kalimin me qëllim arkëtimi* “. Prandaj , Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret personi i cili ka ushtruar prapësimin kundër urdhrin për përmbarim është i pasafatshëm, për shkak se në rastin konkret debitori ka pranuar urdhërin përmbarimor me datën 16.09.2022, ndërsa afati i paraqitjes e prapësimin ke filluar të rrjedhë nga data 17.09.2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 23.09.2022 dhe nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin mënyrë tjetër, prandaj ka ardhur në përfundim se debitori e ka paraqitur prapësimin me 14 ditë me vonesë. Andaj, Kjo Gjykate vlerëson se prapësimi i ushtruar nga debitori është i pasafatshëm.

Me dispozitën e Ligjin e Procedurës Përmbarimor përkatësisht dispozitën e nenit 70 ku përcaktohet se: “*Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues*”. Ndërsa më dispozitën e nenit 126 par.2 të LPP-së theksohet se: “*Në qoftë se kreditori nuk e cakton në mënyrë decidive llojin e kalimit të kredisë, konsiderohet se e propozon kalimin me qëllim arkëtimi* “. Andaj, Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka hedhur poshtë prapësimin si të pasafatshme, duke vendosur si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitivin të këtij aktvendimi. Andaj, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka hedhur si të pasafatshme prapësimin e ushtruar nga debitori dhe ka mbetur në fuqi urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.512/2022 të datës 13.09.2022.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.32/24 dt. 04.06.2024**

**Gjyqtar,  
Faton Bajrami d.v.**